

## MENDIM PARALEL

Unë, Lulzim Hamitaj, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues që ka kryer procesin e rivlerësimit kalimtar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Lulaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndonëse e mbështes vendimmarrjen përfundimtare dhe argumentimin e përgjithshëm në vendimin përkatës, nuk jam dakord me aplikimin, në këtë rast, të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi, sipas meje, nuk ka mjaftueshëm elemente të provuara për të konkluduar mbi cenimin e besimit të publikut nga ky subjekt. Në vijim po pasqyroj mendimin tim paralel/ndryshe nga arsyetimi i dy anëtareve të trupit gjykues, të bërë në vendimin e Komisionit, në raport me këtë çështje.

1. Lidhur me përdorimin, në funksion të vlerësimit të cenimit të besimit të publikut, të disa rrethanave të konstatuara dhe të trajtuara përgjatë analizës së kriterit të pasurisë, nuk jam dakord me arsyetimet dhe konkluzionet e përshkruara në vendimin në fjalë, konkretisht në raport me pikat 60., 60.1., 60.2., për sa kohë sipas meje këto fakte apo konstatime janë përdorur duke u kualifikuar si shkelje lidhur me rivlerësimin e deklarimeve dhe të burimeve të pasurisë së subjektit, nga momenti që ato janë evidentuar si problematika dhe kanë kontribuar në kualifikimin e masës së shkarkimit, në aplikim të nenit 61, pika 3 e ligjit 84/2016. Nëse të njëjtat fakte do të ripërdroreshin për një rikualifikim të dytë në mbështetje, këtë herë, edhe të aplikimit të pikës 5 të kësaj dispozite, atëherë do të gjendeshim përballë një penalizimi të padrejtë dhe të dyfishtë të subjektit, duke u bazuar mbi të njëjtat rrethana faktike. Kjo do të binte ndesh me parimin e proporcionalitetit, pasi deformon atë ekuilibër që duhet të ruhet dhe të jetë gjithmonë prezent në një raport të drejtë midis shkakut dhe pasojës, dhe kështu do të kishim një dyfishim të pasojës për të njëjtat shkaqe apo shkelje. Gjithashtu, kjo qasje nuk do të ishte në përputhje as me jurisprundencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>1</sup>, që ka qartësuar pamundësinë e një kualifikimi të dyfishtë mbi konstatimet dhe faktet e provuara përgjatë hetimit administrativ.
2. Nga ana tjetër vlerësoj se, në rastin konkret, problematikat e konstatuara lidhur me një dosje profesionale nuk mund të mjaftojnë për të mbritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, pasi, sikurse parashikohet nga dispozitat përkatëse dhe është evidentuar në mënyrë konstante edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, vlerësimi dhe konkludimi mbi cenimin e mundshëm të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë nga një subjekt, duhet të kryhet dhe të burojë nga analizimi dhe shqyrtimi i përgjithshëm i çështjes dhe jo vetëm mbi një aspekt. Në këtë rast, vlerësimi do të kufizohej në perimetrin e vetëm të një dosjeje profesionale, për sa kohë elementet që lidhen me kriterin e pasurisë, sikurse u qartësua më sipër, nuk konsiderohen të (ri) përdorshëm, për sa kohë ato e kanë shteruar aftësinë e tyre “ndëshkuese”, nga momenti që e kanë kryer këtë funksion, duke i prodhuar efektet e pasojat respektive brenda kuadrit të kriterit të pasurisë.
3. Gjithashtu, *a contrario sensu*, nëse vetëm për një moment do të përqëndronim analizën dhe vlerësimin tonë për këtë subjekt vetëm mbi kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të aftësive profesionale – duke e konsideruar të shteruar shqyrtimin e kriterit të pasurisë, me problematikat dhe pasojat e evidentuara brenda tij – do të rezultonin vetëm problematikat

---

<sup>1</sup> Shiko vendimin e KPA-së nr. 8/2021, par. 28.2.

e një dosjeje të vetme, të përshkruara në rezultatet e hetimit, për sa kohë lidhur me kriterin e figurës nuk janë konstatuar as probleme e as janë ngritur dyshime. Atëherë, duke e abstraguar kriterin e pasurisë dhe duke aplikuar pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, në këtë rast do të pranohej logjika se ky subjekt do të shkarkohej, vetëm për një dosje profesionale me probleme relative – edhe nëse nuk do të kishte rezultuar asnjë shkelje për kriterin e pasurisë, pra edhe nëse nuk do të kishte shkak për të aplikuar nenin 61, pika 3. Unë distancohem nga kjo logjikë, pasi më rezultojnë tejet joproportionale, pasi bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe nuk mban në vëmendje qëndrimet dhe orientimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili ka vlerësuar të pamjaftueshme për aplikimin e nenit 61, pika 5 apo pika 4, edhe në çështje<sup>2</sup> ku janë konstatuar disa dosje profesionale me problematika të ndryshme. Kësisoj, aplikimi i masës së shkarkimit në këtë rast, për cenim të besimit të publikut (pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016), referuar vetëm për sa është konstatuar brenda kriterit të aftësive profesionale, lidhur me një dosje, nuk vlerësohet i drejtë.

Në këto kushte çmoj se, nisur nga rrethanat dhe faktet e njohura nga Komisioni dhe të përshkruara në vendimin në fjalë dhe në rezultatet e hetimit, vlerësoj se në këtë rast është i pabazuar aplikimi i pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Për rrjedhojë dhe në përfundim, në vlerësimin tim, ky shkak nuk mund të konsiderohej si i provuar dhe nuk duhej të përdorej nga Komisioni për shkarkimin e subjektit z. Artan Lulaj, ndonëse për këtë masë disiplinore janë konstatuar e provuar shkaqe të tjera, që justifikojnë aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe që janë pjesë e vendi mit *de quo*.

## **ANËTARI I TRUPIT GJYKUES**

**Lulzim HAMITAJ / me mendim paralel**

---

<sup>2</sup> Shiko vendimin e KPA-së nr. 28/2020.